



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Shërbimi Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës

Univerziteteske Bolničke i Kliničke Sluzbe Kosova

Hospital and University Clinical Service of Kosovo

Qendra Klinike Universitare e Kosovës

Universitetski Klinicki Centar Kosova

University Clinical Center of Kosova



Në bazë të nenit 79, paragrafi 7 nënparagrafi 7.3 të Ligjit Nr.08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Rregullores (QRK) Nr. 03/2024 për Themelimin e Marrëdhënies së Punës me Kontratë për Periudhë të Caktuar, Sektorit i Personelit të QKUK-së, me datë 18.06.2026, shpall këtë :

KONKURS PUBLIK

Titulli i pozitës së punës : Mjek specialist

Klasa: H8

Nr. i kërkuar: 1

Kohëzgjatja e kontratës: dy (2) vite

Lloji i kontratës: kontratë pune me kohë të caktuar

Data e njoftimit: 18/06/2026

~~**Asati për aplikimin:** 18/06/2026 - 25/06/2026~~

Institucioni: Qendra Klinike Universitare e Kosovës

Klinika: Klinika e Anestezionit dhe Mjekimit Intensiv

Nr. referencës: QKUK 06/2026-08/1

1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Kryen vlerësimin para-anestezik të pacientëve dhe përcakton planin e anestezisë në përputhje me gjendjen klinike të pacientit;
- Ofron dhe monitoron të gjitha format e anestezisë (të përgjithshme, rajonale, lokale dhe sedative) sipas standardeve profesionale dhe protokolleve klinike;
- Monitoron parametrat vitalë të pacientit gjatë procedurave operative dhe ndërhyr në rast të komplikimeve ose emergjencave mjekësore;
- Ofron kujdes intensiv dhe trajtim për pacientët kritikë në njësitë e mjekimit intensive;
- Merr pjesë në reanimimin kardiopulmonar dhe menaxhimin e rasteve urgjente brenda institucionit;
- Menaxhon dhimbjen akute dhe kronike në përputhje me protokollet profesionale;
- Dokumenton të gjitha procedurat, trajtimet dhe intervenimet e kryera në dokumentacionin mjekësor përkatës;
- Bashkëpunon me ekipet multidisiplinare për planifikimin dhe realizimin e trajtimit të pacientëve;
- Siguron respektimin e standardeve profesionale, etike, ligjore dhe të sigurisë së pacientit;
- Merr pjesë në kujdestari, gatishmëri pune dhe organizime të tjera të punës sipas nevojave të institucionit;
- Merr pjesë në aktivitete profesionale, shkencore, edukative dhe programe të edukimit të vazhdueshëm profesional;
- Bashkëpunon dhe mbikëqyr mjekët specializantë, mjekët e rinj dhe personelin tjetër shëndetësor në fushën e anesteziologjisë;
- Zbaton politikat, procedurat, udhëzimet klinike dhe aktet normative të institucionit;
- Kryen edhe detyra të tjera profesionale që lidhen me fushëveprimin e anesteziologjisë, sipas kërkesës së eprorit dhe nevojave të institucionit.

2. Kriteret e përgjithshme për pranimin në detyrë, sipas nenit 9 të LZP-së

1. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
2. Të ketë zotësi të plotë për veprim, sipas legjislacionit në fuqi;
3. Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
4. Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
5. Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale me dashje;
6. Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik.
7. Të ketë zotësi të paktën njëri nga kushtet e mëposhtme për pranimin në detyrë: të jetë bashkëpunues i institucionit apo grupin përkatës.
8. Të kalojë me sukses procedurat e pranimit të përcaktuara në këtë ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: diplomë e fakultetit të mjekësisë, certifikat e specializimit nga lëmia përkatëse.
 - Kërkesat specifike: licenca e punës valide.
-

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- Njohuri bazike profesionale dhe mbështetëse specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar përmes arsimimit dhe trajnimeve bazike;
- Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar praktikat operative me procedurat standarde në një fushë të caktuar;
- Njohuri lidhur me procedurat standarde në një fushë të caktuar;
- Aftësi për të punuar me vetë iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët.

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

- ✚ Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës;
- ✚ Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së punës në pozitë;
- ✚ Dëshmi që nuk ka në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik (vlen për të punësuarit në institucione publike). Kandidatët që nuk janë të punësuar në institucione publike duhet të dërgojnë një vetëdeklaratë me shkrim të nënshkruar se nuk kanë masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✚ Certifikatë mbi dënimet penale origjinale e lëshuar nga gjykata përmes së cilës dëshmohet se nuk është i/e dënuar për kryerjen e veprës penale me dashje, jo më të vjetër se (6) muaj nga data e lëshimit;
- ✚ Kopjet e dokumenteve tjera që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.

Dëshmitë që nuk kërkohen gjatë aplikimit, por në fazën e verifikimit para emërimit

- Dëshmi se kandidati është i aftë në pikëpamje shëndetësore;
- Dëshmi përkatëse se kandidati ka zotësi të plotë për të vepruar;
- Diploma/licenca e noterizuar.

6. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Intervista – maksimumi 100 pikë.

7. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes webfaqes së ShSKUK-së. (shskuk.rks-gov.net)

8. Mënyra e aplikimit

- Njoftimi në SIMBNJ 8 ditë nga dita e publikimit më 18.06.2026, dorëzimi i aplikacioneve në Sektorin e Personelit të QKUK-së bëhet brenda 8 ditëve dhe aplikacioni pranohet deri më datë 25.06.2026.

9. Data e shpalljes së rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes webfaqes elektronike të ShSKUK-së. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

- Pas përzgjedhjes së kandidatit fitues, njëسيا përgjegjëse bën verifikimin para emërimit me qëllim të vërtetimit se kandidatët vazhdojnë të plotësojnë kriteret e konkursit, përmes dokumenteve në origjinal apo të njësuara me origjinalin.

Vëmendje: aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.



Sektorit i Personelit të QKUK-së